



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU KOSOVO COMPETITION AUTHORITY
Nr.i Prot./Br. Prot./Prot.No.	655/23-02/B 16
Nr.i Fq./Br. St./No.Pg.	
Data/Datum/Date:	21.12.2023.
POLIS KOMPETITIVITETI KOSOVO	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenčiju - Competition Authority



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 26 (1), (1.1) dhe neni 51, në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

UDHËZUES NR. 04/2023 PËR MENAXHIMIN E INFORMACIONEVE QË PËRMBAJNË SEKRETE TREGTARE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Ligji 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejmë - Ligji) parashev që Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë - AKRK), do të autorizojë konfidencialitetin e informacionit për aq sa ato përmbajnë sekrete tregtare të një personi, veçanërisht:
 - 1.1. në konkluzionin për fillimin e procedurës të miratuar nga AKRK-ja, në pajtim me nenin 38 parografi 1 të ligjit mbulohet ose hiqet pjesa që përmban sekrete tregtare;
 - 1.2. e drejta e qasjes në dosje sipas nenit 45 parografi 5, nuk përfshihet në pjesët e dosjes që përmbajnë sekrete tregtare;
 - 1.3. njoftimi për vërtetimin paraprak të fakteve i nxjerrë sipas nenit 46 të ligjit nuk duhet të përmbajë sekret tregtar;
 - 1.4. sipas nenit 48 parografi 2 të ligjit, AKRK-ja mund ta përjashtojë publikun nga seanca dëgjimore për të ruajtur sekretin tregtar;
 - 1.5. sipas nenit 56 parografi 5 të Ligjit, pjesa që përmban sekrete tregtare mbulohet ose hiqet nga vendimet e AKRK-së të dorëzuar ose të publikuara.
2. Ky Udhëzues për menaxhimin e informacionit që përmban sekrete tregtare (në tekstin e mëtejmë - Udhëzuesi) ofrojnë udhëzime për identifikimin e sekreteve tregtare siç janë të përcaktuara në nenin 51 të Ligjit, si dhe përshkruan procedurën për pretendimin e konfidencialitetit të informacionit që përmban sekrete tregtare.
3. Termat e përdorur në Udhëzues korrespondojnë me përkufizimet e përdorura në Ligj.

II. KONCEPTI I SEKRETEVE TREGTARE

1. Sipas nenit 51 të ligjit sekretet tregtare (sekret tregtar ose afarist) janë informacionet që kanë vlerë tregu aktuale ose të mundshme dhe informacionet kur zbulimi ose përdorimi i të cilave mund t'i japë përparësi ekonomike një ndërmarrjeje tjetër.
2. Neni 51 paragrafi 4 parashev që gjatë vlerësimit nëse informacioni përbën sekret tregtar, AKRK-ja duhet të ketë parasysh:
 - 2.1. Posedimin e informacionit jashtë ndërmarrjes;
 - 2.2. Masat e ndërmarrjes për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit në veçanti klauzolat që ndalojnë konkurrencën dhe ndalojnë zbulimin e informacionit në kontratat e punës dhe kontratat e ngjashme;
 - 2.3. Vlera e informacionit për ndërmarrjen dhe konkurrentët.

3. Duhet theksuar se sekretet tregtare janë informacione konfidenciale për veprimtarinë e biznesit të një ndërmarrjeje, zbulimi i të cilave jo vetëm për publikun, por edhe thjeshtë transmetimi i tyre tek një person tjetër nga ai që e ka dhënë informacionin, mund të dëmtojë seriozisht interesat e këtij të fundit. Që informacioni të konsiderohet konfidencial, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

3.1. informacioni duhet të jetë i njojur vetëm për një numër të kufizuar personash;

3.2. zbulimi i tij duhet t'i shkaktojë dëm serioz personit që e ka dhënë ose palëve të treta; dhe

3.3. interesat që mund të dëmtohen nga zbulimi duhet të jenë objektivisht të denjë për mbrojtje; Për shembull, interesi i një ndërmarrjeje që e ka shkelur ligjin, në mos-zbulimin publik të detajeve të sjelljes që përbëjnë shkeljen, nuk duhet të jetë objektivisht i denjë për mbrojtje. Prandaj, një informacion i tillë nuk duhet të trajtohet si i një natyre konfidenciale.

4. Në pajtim me nenin 51 paragrafi 2 të ligjit, kriteret e përcaktuara në paragrafët 4, 5 dhe 6 të Udhëzuesit nuk janë të zbatueshme nëse një informacion i caktuar me ligj ose akt nënligjor është përcaktuar si sekret tregtar.

5. Shembuj informacioni që mund të kualifikohen si sekrete tregtare përfshijnë:

5.1. informacion teknik dhe/ose financiar në lidhje me njojuritë e një ndërmarrjeje;

5.2. metodat e vlerësimit të kostove;

5.3. sekretet dhe proceset e prodhimit,

5.4. burimet e furnizimit;

5.5. sasitë e produhuara dhe të shitura;

5.6. pjesëmarjet në treg;

5.7. listat e klientëve dhe distributorëve;

5.8. planet e marketingut;

5.9. struktura e kostos dhe çmimit dhe strategjia e shitjeve.

6. Sekretet tregtare që i zbulohen një shoqate nga anëtarët e saj nuk e humbasin natyrën e tyre konfidenciale përballë palëve të treta dhe një informacion i tillë mund të konsiderohet sekret tregtar nëse plotëson të gjitha kërkesat për një informacion të tillë.

7. Vlerësimi nëse një informacion i caktuar përmban sekrete tregtare duhet të bëhet rast pas rasti. Informacioni që nuk përbush kërkesat e parashikuara në paragrafët 4, 5 dhe 6 të udhëzuesit nuk do të konsiderohet si sekret tregtar.

8. Në veçanti, informacioni në lidhje me një ndërmarrje që tashmë njihet jashtë ndërmarrjes (në rastin e një grupei ndërmarrjesh të lidhura, jashtë grupit), ose jashtë shoqatës së cilës i është komunikuar nga ajo ndërmarrje, zakonisht nuk do të konsiderohet si konfidenciale. Që informacioni të humbasë natyrën e tij konfidenciale mjafton që ai të jetë i disponueshëm për qarqet e specializuara ose të mund të nxirret nga informacioni i disponueshëm publikisht.

9. Informacioni që ka humbur rëndësinë e tij tregtare, për shembull për shkak të kalimit të kohës, gjithashtu nuk mund të konsiderohet më si konfidencial. Një periudhë prej pesë vjetësh konsiderohet e mjaftueshme që informacioni të humbasë kualifikimin e tij si sekret tregtar. Trajtimi konfidencial i informacionit mund t'u jepet këtyre të dhënave vetëm në raste të veçanta, nëse mund të tregohet se ato ende përbëjnë elementë thelbësor të pozicionit tregtar të ndërmarrjes në fjalë, pavarësisht nga natyra e tyre historike.

10. Në bazë të nenit 51 paragrafit 5 të Ligjit, nuk konsiderohen sekret tregtar:

10.1. informatat e qasshme për publikun, duke përfshirë informatat që mund të sigurohen nga institucionet dhe shërbimet e specializuara dhe informatat botërisht të ditura nga ekspertët;

10.2. raportet vjetore financiare dhe raportet statistikore si dhe të dhënat për të hyrat e përgjithshme që publikohen në reportin finansiar vjetor ose të dhënët e qasshme në një mënyrë tjetër;

10.3. të dhënat dhe dokumentet në të cilat bazohet vendimi i AKRK-së.

III. PROCEDURA PËR TË KËRKA KONFIDENCIALITETIN E SEKRETEVE TREGTARE

1. Sipas nenit 39, paragrafi 5 të ligjit, nëse një person konsideron se informatat apo të dhënat të cilat i kërkohen t'ia ofrojë AKRK-së përbëjnë sekret tregtar, personi duhet:

1.1. të identifikojë të dhënat dhe dokumentet që ai ose ajo i konsideron sekret tregtar dhe ta vërtetojë këtë pretendim në përputhje me dispozitat e nenit 51 të ligjit; dhe

1.2. t'i dorëzojë AKRK-së versione jo-konfidenciale të të dhënavë dhe dokumenteve që ai ose ajo pretendon se përbajnjë sekrete tregtare.

2. Në bazë të nenit 39, paragrafi 6 të ligjit, nëse personi nuk i plotëson kërkuesit e përcaktuara në paragrafin 14 të Udhëzuesit edhe pas kërkuesave të përsëritura nga AKRK-ja, dokumentet dhe të dhënat e ofruara nga personi nuk konsiderohen si sekrete tregtare. Vulat standarde të konfidencialitetit në letrat nga firmat ligjore ose përjashtimet nga përgjegjësia automatike në emaile nuk konsiderohen nga AKRK-ja si kërkesa për trajtim konfidencial.

3. Kërkesa për të vërtetuar pretendimet lidhur me sekretet komerciale do të thotë që personi që pretendon këtë lloj konfidencialiteti duhet t'i ofrojë AKRK-së të gjitha detajet relevante në mënyrë që t'i mundësojë asaj të vlerësojë konfidencialitetin e një informacioni të caktuar. Për këtë qëllim, personi duhet të mbështesë çdo pretendim për konfidencialitet me shkrim, duke shpjeguar:

3.1. arsyet pse informacioni në fjalë përbën sekret tregtar; dhe

3.2. në veçanti, se si zbulimi i këtij informacioni do t'i shkaktonte dëm serioz personit që e jep këtë informacion ose palëve të treta.

4. Arsyetimet standarde si “sekret tregtar” ose “informacion i panjohur për palën tjetër” parandonjë arsyetim, AKRK-ja nuk konsiderohen si vërtetim i duhur i sekretit tregtar.

5. Versioni jo-konfidencial i parashtrës/dokumenteve duhet të pasqyrojë versionin konfidencial për sa i përket numrit të faqeve dhe formatit të tij. Nëse kërkohet konfidencialitet për ndonjë pjesë të dokumentit, AKRK-së duhet t'i sigurohet një version jo-konfidencial i të gjithë dokumentit.

6. Si rregull konfidencialiteti nuk mund të kërkohet për një dokument të tërë ose pjesë të tëra të tij. Zakonisht është e mundur që informacioni konfidencial të mbrohet me redaktime të kufizuara. Faqet tërësisht të zbrazëta ose të mbuluara nuk do të pranohen nga AKRK-ja. Së paku, titujt e dokumenteve dhe/ose titujt e kolonave të përfshira në tabelë dhe fotografi, si dhe çdo listë e shtojcave duhet të lihen të paprekura.

7. Për çdo informacion që pretendohet se është konfidencial për shkak të sekretit tregtar, AKRK-së duhet t'i ofrohet një përbledhje koncize por kuptimplotë jo-konfidenciale. Kur informacioni konfidencial ka të bëjë me shifra të tillë si pjesëmarjet në treg ose shifrat e qarkullimit, në versionet jo-konfidenciale duhet të tregohen varietete (përfaqësimë) të shifrave të tillë. Për sa i përket të dhënavë të shitjeve dhe/ose qarkullimit duhet të tregohen varietete jo më të mëdha se njëzet për qind (20%) e shumave totale përkatëse. Shifrat relative të tillë si pjesët e tregut (në përqindje %) duhet të tregohen në intervale jo më të gjera se pesë përqind (5%).

8. Për arsyet e efikasitetit administrativ, AKRK-ja mund të kërkojë nga personi që pretendon konfidencialitet që së pari të ofrojë një draft version jo-konfidencial të parashtrësave/

/dokumenteve, në të cilin informacioni që pretendohet se është konfidencial është i theksuar por mbetet i lexueshëm. Pasi AKRK-ja të ketë pranuar përkohësisht pretendimet përkatëse për konfidencialitet, personit do t'i kërkohet të dorëzojë një version përfundimtar jo-konfidencial në të cilin informacionet konfidenciale janë fshirë. AKRK-ja rezervon të drejtën që në një fazë të mëvonshme të procedurës të rishqyrtojë vlerësimin fillestar të këtyre kërkesave për konfidencialitet.

9. Për lehtësi, arsyetimet dhe përbledhjet jo-konfidenciale për secilën pjesë të informacionit që pretendohet se është konfidenciale mund t'i paraqiten AKRK-së në formën e një tabele të ofruar më poshtë:

ID # (nëse disponohet)	Fshirjet në faqen # të versionit origjinal konfidencial/paragrafi # (tregoni shtojcën # aty ku është e rendësishme)	Arsyet e kërkesës për konfidencialitet	Përbledhje jo konfidenciale

10. Versionet jo-konfidenciale të parashtresave/dokumenteve së bashku me përbledhjet jo-konfidenciale dhe arsyetimet e pretendimeve për sekret tregtar do të duhet të jenë të qasshme për palët që kanë të drejtë të kenë qasje në dosje. Prandaj, përbledhjet dhe arsyetimet e kërkesave për sekret tregtar të dorëzuara në AKRK nuk duhet të përbajnë asnje informacion konfidencial. Veçoritë e dokumenteve elektronike gjithashtu nuk duhet të përbajnëasnje informacion konfidencial. AKRK-ja do të supozojë se përbledhjet dhe arsyetimet e pretendimeve për konfidencialitet, si dhe veçoritë e versioneve jo-konfidenciale të dorëzuara janë jo-konfidenciale.

11. Gjatë procesit të qasjes në dosje në AKRK, versionet jo-konfidenciale të parashtresave/dokumenteve do t'u bëhen të qasshme palëve në procedurë në të njëjtin format në të cilin janë dorëzuar në AKRK. Është përgjegjësi e personave që dorëzojnë dokumentet ose të dhënët përkatëse në AKRK për të siguruar që versionet jo-konfidenciale të ofruara janë teknikisht të besueshme dhe informacionet e redaktuara nuk mund të merren me asnje mjet, duke përfshirë mjetet forenzike. AKRK-ja nuk merr asnje përgjegjësi për versionet jo-konfidenciale të mbuluara në mënyrë të pamjaftueshme.

12. Në bazë të nenit 51 parografi 5 të ligjit, të dhënët dhe dokumentet në të cilat bazohet vendimi i AKRK-së nuk konsiderohen si sekret tregtar. Kjo dispozitë nënkupton që edhe nëse një person pretendon se të dhënët ose dokumentet e veçanta janë konfidenciale, AKRK-ja ka të drejtë t'i zbulojë këto të dhëna ose dokumente nëse ato janë të nevojshme për të vërtetuar një vendim të AKRK-së. Kur AKRK-ja synon të zbulojë të dhënët ose dokumentet duke u mbështetur në nenin 51 parografi 5 të ligjit, personit i cili ka ofruar të dhënët ose dokumentet do t'i jepet mundësia të ofrojë një version jo-konfidencial të të dhënave ose dokumenteve ku ai informacion përmban të njëjtën vlerë provuese sikurse versionet origjinale konfidenciale.

HYRJA NË FUQI

Ky Udhëzues hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neime Binaku-Isufi

Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës



Aneks
Shembuj të pretendimeve për sekret tregtar:
si të jepen arsyet dhe përbledhjet jo-konfidenciale

Kjo tabelë jep shembuj të arsyetimit të kërkesës për konfidencialitet të sekreteve tregtare dhe të përbledhjeve jo-konfidenciale. Kjo tabelë është dhënë si shembull dhe nuk është shteruese.

ID # (nëse është në dispozicion)	Fshirjet në faqen # të versionit origjinal konfidencial/paragrafi # (tregoni shtojcën # aty ku është e rëndësishme)	Arsyet e kërkesës për konfidencialitet	Përbledhje jo konfidenciale
	Faqet 1-3	Kompania A ka negociata të vazhdueshme për çmimin me kompaninë B. Njohja e strategjisë së saj të çmimeve nga kompania B do të minonte seriozisht pozicionet negocuese të kompanisë A në negociatat në vazhdim dhe për kontratat e ardhshme të furnizimit.	Mbledhja e bordit të [Data] në lidhje me strategjinë e çmimeve ndaj Kompanisë B
	Faqe 6	Projekti i mundshëm me konkurrentin e kompanisë B. Projekti është ende i zbatueshëm. Njohja e detajeve të këtyre diskutimeve do të dëmtonte mundësitë aktuale dhe të ardhshme të biznesit të Kompanisë A.	Korrespondencë e brendshme e-mail e [Data] në lidhje me furnizimin në [EMRI I NJË VENDI/ZONË GJEOGRAFIKE]
	Faqe 18	Informacione të fundit për kostot e prodhimit, fitimet ose informacione të tjera financiare që janë të rëndësishme për strategjinë aktuale të biznesit dhe marrëdhëni tregtare.	Informacion strategjik dhe tregtar për operacionet e Kompanisë A, që përfshin informacion mbi kostot e prodhimit, fitimet dhe informacione të tjera financiare
	Faqet 54-57	Dokumenti përmban detaje të strategjisë së biznesit të kompanisë A dhe informacione të ndjeshme mbi të dhënat kryesore tregtare të cilat nuk janë të njoitura publikisht dhe	Përbledhja e Menaxhimit të Brendshëm - Grafiku i [Data] për vëllimet, çmimet, struktura e kontratës dhe strategjia e

		njohuria e të cilave nga furnizuesi Kompania B, do të dëmtonte seriozisht interesat e biznesit të kompanisë A dhe do të zbulonte strategjinë e saj për kompaninë B, e cila do të ndikonte në pozicionin e kompanisë A në diskutimet në të ardhmen për furnizimin me kompaninë B.	biznesit në [PRODUKTI DHE ZONA GJEOGRAFIKE NË FJALË]
	Faqet 2, 5 dhe 8	Fshirjet kanë të bëjnë me një vlerësim të brendshëm të procesverbaleve të takimeve me kompaninë B. Kompania A ka marrëdhëniet biznesi të vazhdueshme me kompaninë B. Nëse zbulohet, informacioni do t'i japë kompanisë B njohuri mbi strategjitet e negociatave të kompanisë A, supozimet e brendshme dhe do të dëmtojë seriozisht pozicionin e kompanisë A në diskutimet e ardhshme të furnizimit me Kompaninë B.	Procesverbalet e takimeve me kompaninë B të [Data]
	Faqe 12	Informacioni i planifikimit të brendshëm strategjik mbi sasinë dhe kostot e lëndëve të para, detyrimet kontraktuale, proceset teknike, patentat etj.	Informacioni i planifikimit të brendshëm strategjik
	Faqe 1	Diskutim i brendshëm mbi situatën financiare të kompanisë (kushtet e politikave të borxhit/aseteve financiare, politikat e pagave, etj.).	Diskutim i brendshëm mbi gjendjen financiare të kompanisë
	Faqe 18	Informacion në lidhje me marrëdhëniet tregtare dypalëshe me një klient (një raport takimi), që nuk i është zbuluar konkurrentëve të tjera.	Informacion në lidhje me marrëdhëniet tregtare dypalëshe me një klient